



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E ARSIMIT

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 62, paragrafi 62.3 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 57, pika c të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01 – 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe në dispozitat e nenit 6, të Rregullores nr. 01-110-41917, dt. 29.03.2013 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Prishtinës, drejtori i Drejtorisë për arsim shpall:

K O N K U R S

PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I. Komuna e Prishtinës ndanë **120 bursa** për studentët, që studiojnë në universitetet publike të Kosovës , për vitin akademik 2014/2015, në këto fusha të studimit:

Fakulteti i Arteve	pesë (5) bursa
Fakulteti i Shkencave Sportive.....	pesë (5) bursa
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.....	tetë (8) bursa
Fakulteti Filozofik.....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës	dhjetë (10) bursa
Fakulteti i Mjekësisë.....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti i shkencave matematiko-natyrore.....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti Filologjik.....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti i Edukimit.....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti Juridik.....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti Ekonomik	dhjetë (10) bursa
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike ...	dymbëdhjetë (12) bursa

II. Vetëm studentët/et e rregullt, se paku 10 vjetë banorë të komunës së Prishtinës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të universiteteve publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoratë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave të studimeve.

Faqe 1 nga 3

III. Kriteret e përgjithshme:

1. të kenë regjistruar vitin akademik për te cilin jepet bursa;
2. të mos jetë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar;
3. Te mos jetë përsëritës i vitit akademik;
4. të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomiko-sociale të familjes.
5. studentët që janë regjistruar për herë të parë në fakultete, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme.

IV. Kriteret e veçanta:

1. nota mesatare mbi 9 (nëntë) vlerësohet me 30 pikë,
2. nota mesatare mbi 8 (tetë) vlerësohet me 20 pikë,
3. nota mesatare mbi 7 (shtatë) vlerësohet me 15 pikë,
4. studentët në asistencë sociale vlerësohen me 20 pikë,
5. studentët që studiojnë në lëndët deficitare vlerësohen me 15 pikë,
6. ai/ajo, që studion së bashku me një anëtar tjetër nga e njëjta familje vlerësohet me 10 pikë,
7. ai/ajo, që nuk i ka prindërit në jetë, vlerësohet me 10 pikë,
8. studentët me aftësi të kufizuara vlerësohen me 10 pikë.

Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura në piken IV, do të kenë përparësi studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës, të gjinisë femërore dhe studentët që udhëtojnë nga fshati me larg se 15 km.

V. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Aplikacioni sipas formës së Komunës;
2. Vërtetimi se studenti ka regjistruar vitin akademik 2014/2015 (origjinale);
3. Certifikata e notave (origjinale);
4. Vërtetimi që studenti nuk është përfitues i bursës universitare (origjinale);
5. Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm;
6. Kopja e letërnjoftimit;
7. Vërtetimi se është anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorëve,
8. Certifikata mbi gjendjen ekonomike (në emër të prindit);
9. Vendimi mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2013/2014;
10. Për studentet e regjistruar në vitin akademik 2014/2015 kopjet e vërtetuara të dëftesave dhe të diplomës së shkollës paraprake.

Vërejtje: Dokumente e pakompletuara dhe ato te dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Për përzgjedhjen e përfituesve të bursës komunale do të formohet komisioni me vendim të veçantë.

Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik. Aplikacioni i kërkesës merret dhe i plotësuar dorëzohen në sportelet e katit përdhes të Komunës të Pishinës (ndërtesa e vjetër), çdo ditë pune prej orës 10:00 deri 15:00.